

UDHËZIM
Nr.34, datë 2.11.2009

**PËR ORGANIZIMIN E VEPRIMTARIVE NË SHËRBIM TË NXËNËSVE NË ARSIMIN
PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 53 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar,

URDHËZOJ:

1. Organizimi i veprimtarive në shërbim të nxënësve në arsimin parauniversitar, të jetë si më poshtë:

- a) Konsultime me talentet dhe nxënësit që kanë nevojë për ndihmë;
- b) Veprimtaritë kulturore, sportive;
- c) Rrethet lëndore.

2. Çdo mësues i sistemit arsimor parauniversitar të kryejë 1 (një) orë në ditë veprimtari, përveç orëve të planifikuara në orarin mësimor, sipas një grafiku të hartuar dhe të monitoruar nga drejtoria e shkollës.

3. Mësuesit që janë në marrëdhënie pune në sektorin publik nuk mund të kryejnë mësim dhe kurse private.

4. DAR/ZA ndërmerr masat e nevojshme për zhvillimin dhe monitorimin e veprimtarive në shkolla sipas një pasqyre të plotë të planit të veprimtarive dhe orarit të tyre për çdo shkollë.

5. Efektiviteti i veprimtarive është pjesë e vlerësimeve vjetore të punës së mësuesve dhe të drejtuesve të shkollave.

6. Shkolla përcakton nevojat mësimore të grupeve të nxënësve të saj dhe harton planin e veprimtarive sipas këtyre nevojave.

7. Plani i veprimtarive të jetë pjesë e orarit të mësimave të shkollës.

8. Drejtoria e shkollës monitoron realizimin dhe efektivitetin e veprimtarive dhe i analizon periodikisht në mbledhjet e këshillit të mësuesve.

9. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Parauniversitare, DAR/ZA dhe drejtoritë e shkollave.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj